



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.90 dt.15.05.1997

**PËR NDARJEN E APARTAMENTEVE NË RR."R.CUKA",**

Këshilli Bashkisë Tiranë, në mbledhjen e tij të dt.15.05.1997, pasi shqyrtoi Relacionin e Drejtorisë së Ndërtim Strehimit për ndarjen e apartamenteve në Rr."R.Cuka", dhe pasi dëgjoi relatimin e Komisionit të Shërbimeve Publike të Këshillit Bashkiak.

**VENDOSI**

1. Të ngrihet një grup pune i përbërë nga spacialistë të Sektorit të Strehimit në Drejtorinë e Ndërtim Strehimit, Juristë dhe Ing.Komunalistë të Nj.Administrative, për të evidentuar gjendjen faktike të 300 apartamenteve të patrajuara nga ana e Këshillit Bashkiak për periudhën 4 vjeçare të kaluar dhe të paraqesin në Këshillin Bashkiak një relacion mbi mënyrën e trajtimit dhe problemet të këtyre apartamenteve.
2. Grupi i punës të paraqesë relacionin në një afat kohor 1(një) muaj, nga afati i hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**